



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	04.04.2022	2	viti god year
Organ / Agjencia Org / Unit	Nr. Prot Pr. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	1848/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.267/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2120/2021 të datës 16.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.608/2021 të datës 02.07.2021 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Komunës së Drenasit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.608/2021 të datës 02.07.2021 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 06.06.2012 në pozitën "Zyrtar i Lartë për Shtetësi dhe Vendbanim" pranë Komunës së Drenasit, është njoftuar më datë 22.02.2021 nga Zyra e Personelit e Komunës së Drenasit që më datë 22.08.2021 i përfundon marrëdhënia e punës me rastin e pensionimit. Ankuesja më datë 03.06.2021 ka paraqitur kërkesë tek Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Financa dhe Zyra e Personelit më të cilën ka kërkuar të paguhet tri paga shtesë dhe tri paga jubilarë. Zyra e Personelit ka njoftuar ankuesen që shpërblimin jubilar e kë realizuar në vitin 2017 ndërsa me arritjen e moshës së pensionimit ju takon një pagë e njëhershme në vlerën e pagës së fundit sipas Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civilë.

Ankuesja kundër këtij njoftimi të Zyrës së Personelit të Komunës së Drenasit, përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net më datë 07.07.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër protokollit 3418/2021 dhe numër të ankesës A.nr.608/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.07.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna e Drenasit. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga Komuna e Drenasit më datë 15.07.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankuesja ka qenë jofunksional, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 30.06.2021 ka shkarkuar pesë anëtarët, andaj në kuptim të kësaj më datë 16.08.2021 kemi njoftuar palën (ankuesen) për arsyet e mos vendosjes së ankesës. Ankuesja ka hapur konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.03.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2120/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëse duke e anuluar njoftimin e datës 16.08.2021 dhe duke e detyruar Këshillin të vendos për ankesën e datës 02.07.2021 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.07.2021 me Nr. Prot:3418/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 03.06.2021 e parashtruar nga ankuesja; Njoftimin nga Zyra e Personelit për ankuesen lidhur me kërkesën e datës 03.06.2021; Akt Emërimit e datës 06.06.2012 për ankuesen; Aktvendim i datës 17.05.1995; Vërtetim i datës 08.05.2006; E-mailin e datës 02.07.2021; Listën e Pagave e muajit nëntor 2017 për ankuesen; E-mailin e datës 19.10.2017 dhe 18.10.2017; Regjistrin e punëtorëve për pagesë të shpërblimit jubilar i datës 08.11.2017; Njoftimin e datës 22.02.2021 për ankuesen nga Zyra e Personelit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.07.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 15.07.2021; Njoftimin e datës 16.08.2021 për ankuesen dhe Aktgjykimin A.nr.2120/2021 të datës 16.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është palejuar, sepse është parashtruar para afatit ligjor.*

Bazuar në provat e lëndës, Zyra e Personelit e Komunës së Drenasit, më datë 22.02.2021 ka njoftuar ankuesen se më datë 22.08.2021, arrin moshën e pensionimit, ndërsa ankuesja më datë 03.06.2021 ka paraqitur kërkesë tek Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Financa dhe Zyra e Personelit më të cilën ka kërkuar të paguhen tri paga shtesë dhe tri paga jubilarë, kurse Zyra e Personelit ka njoftuar ankuesen që shpërblimin jubilar e ka realizuar në vitin 2017, ndërsa me



arritjen e moshës së pensionimit ju takon një pagë e njehershme në vlerën e pagës së fundit sipas Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës konstaton se Zyra e Personelit e Komunës së Drenasit ka njoftuar ankuesen për kohën e pensionimit respektivisht gjashtë (6) muaj para pensionimit siç parashihet me nenin 60 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil informohet për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit"*, mirëpo pensionimi i ankuses nuk ka ndodh ende sepse e njëjta do të pensionohet më datë 22.08.2021, rrjedhimisht nuk ka asnjë akt administrativ me të cilën ankueses i është shkëlur e drejta nga marrëdhënia e saj e punës, sepse ngjarja ende nuk ka ndodhur siç parashihet me dispozitat e paragrafit 4 të nenit 60 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, për shkak të ligjit, konstatohet jo më vonë se brenda 5 ditëve nga ndodhja apo njohja e shkakut të përfundimit, nga: Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse përfundimi i marrëdhënies së punës për nëpunësit civil me rastin e pensionimit bëhet me vendim (akt administrativ) nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, atëherë në vendim përcaktohet të drejtë dhe detyrimet ndaj nëpunësit civil, rrjedhimisht në rastin konkret nëpunësit civil nga momenti i pranimit të aktit administrativ i njihet edhe e drejta e ankimit kundër aktit administrativ. Ndërsa në rastin konkret të ankuses njoftimi i datës 22.02.2021 i Zyrës së Personelit nuk është akt administrativ i cili prodhon efekte juridike për ankuesen, si rrjedhojë ankueses nuk i ka lindur asnjë e drejtë që të parashtrij ankesë para se të nxirret vendimi për përfundim të marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit, sepse ankesa parashtrihet kundër një akti administrativ të përcaktuar me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrihet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"*, ndërlidhur me këtë neni 127 paragrafi 1 i këtij ligji ka përcaktuar se: *"Ankesa duhet të parashtrihet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*.

Bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesja ankesën e datës 02.07.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë sepse ende ankueses nuk i është cenuar e drejta nga marrëdhënia e saj e punës, në kundërshtim me nenin 60 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 125 paragrafi 1 dhe 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe gjatë shqyrtimit të bazës ligjore, në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.267/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

